



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prudato Received / Delivery	09.02. 2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLP		SP/2021	13



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A .nr. 438/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 438/2020 të datës 29.12.2020, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me banim në Rr. "Musli Mulliqi" D2-Hyrja 6 M, lagja Ulpiana, Prishtinë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet** ankesa me numër A.nr.438/2020 e datës 29.12.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi KA.nr.33/2020 të datës 23.12.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në pozitën "Auditor i Brendshëm", më datë 29.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 3324/2020 të regjistruar me A.nr.438/2020, kundër Vendimit KA.nr.33/2020 të datës 23.12.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 12.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e lëndës faqe 1/14.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen meritorë të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3324/2020 të datës 29.12.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.01.2021; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Ka.Nr.33/2020 i datës 23.12.2020; E-mailin nga _____ për _____ i datës 09.10.2020; Vendimin me Referencë: DS-708/2020 i datës 20.11.2020; Ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 26.11.2020; Kontratë Pune e datës 06.12.2000; Përgjigje në ankesë e datës 12.01.2021; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 03.11.2020; Akt Emërimi i datës 31.12.2012; E-mailin e datës 28.01.2021; E-mailin e datës 28.01.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është pa bazuar, sepse:

Duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.AGJ 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të datës 09.07.2020, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji ankesën e trajtoj në pajtim me konstatimet lidhur me institucionet e pavarura respektivisht me pikën II dhe III të diapozitivit të këtij aktgjykimi, dhe si rrjedhojë Kolegji konstatoj se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në raport me institucionet sipas pikës III të aktgjykimit, do të zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra për zbatimin e tij.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi KA 33/2020 i datës 23.11.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, është i pa drejtë dhe jo ligjor, sepse deklaron se i janë shkelur të drejtat materiale për kompensim të shpërblimit jubilar pas një pune 20 vjeçare në institucionet e Kosovës.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi ka qenë i punësuar nga data 06.12.2000 deri 19.12.2002 në Departamentin e Drejtësisë në kuadër të UNMIK-ut, ndërsa nga data 19.12.2002 në vazhdimësi ka qenë në marrëdhënie pune në shërbimin civilë, fillimisht në Departamentin e Administratës Gjyqësore në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, ndërsa nga data 31.12.2012 ushtron pozitën e "Auditorit të Brendshëm" në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me datë 09.10.2020 ankuesi përmes e-mailit ka parashtruar kërkesë pranë organit të punësimit për kompensimin e jubilarit të dytë, respektivisht 20 vjetorin e përvojës së punës. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Vendimin Nr. Ref DS-708/2020 të datës 20.11.2020, ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se të njëjti në muajin dhjetor 2012 i është kompensuar shpërblimi jubilar i parë, dhe se ankuesi të drejtën e kompensimit të jubilarit të dytë, do ta fitoj në muajin dhjetor të vitit 2021.

Kundër Vendimit Nr. Ref DS-708/2020 të datës 20.11.2020, ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 26.11.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. KZKA me Vendimin KA.nr.33/2020 të datës 23.12.2020, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e datës 26.11.2020 të parashtruar nga ankuesi. I pa kënaqur me këtë vendim, me datë 29.12.2020 ankuesi ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil me numër protokollit 3324/2020, me pretendimet si më lartë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 Për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësish nën 22 paragrafi 2 ku

përcaktohet se: 2. nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.3. shpërblimi i përvjetorit (jubile),... si dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 21 ku përcaktohet se : *Shpërblimi i përvjetorit (jubilar) sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune,* si rrjedhojë ka konstatuar se nëpunësit civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune i njihet e drejta e realizimit të një shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesit se i njëjti ka plotësuar kushtin që të kompensohet shpërblimi i dytë jubilar, pasi që punon nga dhjetori i vitit 2000, Kolegji konstaton se Shërbimi Civil në Kosovë është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22 dhjetor 2001. Andaj, mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se vetëm marrëdhënia e punës në shërbimin civil nga data 22 dhjetor 2001, ka efekt juridik në kuptim të realizimit të se drejtës për shpërblim jubilar ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar, gjegjësisht ankuesi ende nuk ka plotësuar kushtin për shpërblimin e dytë jubilar.

Rrjedhimisht, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejtë dispozitat materiale lidhur me çështjen ankimore.

Bazuar në këto rrethana, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe bazuar në kompetencën e Këshillit, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetarja e kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 438/2020

Clirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.